



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.8/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e Gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas Ankesës së Avokatit B.K., nga Prizreni parashtruar kundër gjyqtarit G.Sh., Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e Gjyqtari të lartcekur në bazë të së cilës është bërë iniciimi i procedurës disiplinore, me datë 16.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Avokatit B.K., nga Prizreni parashtruar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kundër gjyqtarit G.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren për iniciimin e procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës avokati B.K., në ankesën e parashtruar kundër gjyqtarit G.Sh., ka cekur se në veprimet e gjyqtarit të lartcekur ka pasur veprime procedurale të jashtëzakonshme dhe të qëllimshme për zhagjitjen në lëndën C.nr., ku fillimisht gjatë mbajtjes së seancës përgatitore me datë 20.09.2021 gjykata pranon shtyerjen e mbajtjes së seancës, me arsyetimin se avokati i palës paditëse ka denoncuar autorizimin e paditësve me datë 17.09.2021, gjë që është në kundërshtim me nenin 94 par.4 të LPK-së. Gjithashtu gjykata e ka shtyer edhe seancën e datës 07.10.2021 ku pala paditëse serish e merr avokatin e njëjtë i cili ka cekur se ka një shqyrtim tjetër. Paditësi B.A., është i paditur në të njëjtën gjykatë nga paditësi S.P., për lirim të paluajtshmërisë me objekt të njëjtë të kontestit në lëndën C.nr. dhe gjykata tani ka ndërprerë lëndën për dorëzimin e paluajtshmërisë deri sa të kryhet lënda për vërtetimin e pronësisë. Palës paditëse i konvenon që të shtyhet sa më shumë procedura e vërtetimit të pronësisë në mënyrë që të mos filloj procedura për lirimin e paluajtshmërisë dhe i padituri S.P., të cilin ai e e përfaqëson duhet të pres me vite të tëra që të përfundoj lënda për vërtetim të pronësisë. Gjykata sipas avokatit B.K., vazhdimisht në lëndët që i përfaqëson ai (në kundërshtim me rregullat e LPK-së, respektivisht nenit 44 par. 1) shtyen seancat në pafundësi. Gjyqtari i njëjtë pas caktimit të seancave përgatitore dhe daljes në terren me vite ka shtyer seancat përfundimtare në lëndët C.nr., C.nr., C.nr., C.nr. dhe lëndën C.nr. Gjithashtu ka edhe lëndë në kontekstet e punës te ky gjyqtar që asnjëherë nuk janë caktuar, ka cekur se nuk e din se pse gjyqtari vepron në këtë mënyrë me lëndët që ai i përfaqëson edhe pse asnjëherë asnjë vërejte nuk ka pasur nga ndonjë gjyqtar për sjellje jo korrekte në Gjykatë. i njëjti ka cekur se: " Ndoshta ky gjyqtar e ka edhe ndjenjën e inferioritetit sa i përket anës sime profesionale, pasi që dihet botërisht se i njëjti ka rënë disa herë nga provimi i jurisprudencës". Ka cekur se nuk ankohet për vendimet meritore që i nxjerr Gjyqtari, por veprimet procedurale për shtyerje të pakufishme i pamundësohet palëve t tij që ti realizojnë të drejtat e tyre

ku është duke shqyrtuar mundësinë që ai t'i denoncojë autorizimet në të gjitha lëndët që janë të caktuara te gjyqtari G.Sh., në mënyrë që mos të pësojnë palët në këto çështje.

Avokati gjithashtu me ankesë ka parashtruar edhe Kallëzim Penal ndaj gjyqtarit për shkak të pretendimeve të gjyqtarit G.Sh., sipas lëndës C.nr.

Pas pranimit të ankesës kryetarja ka kërkuar që gjyqtari G.Sh., të deklarohet në lidhje me këtë ankesë dhe nga i njëjti me datë 01.08.2022 ka pranuar deklaratën me shkrim. Në këtë deklaratë gjyqtari G.Sh., ka cekur se këtë lëndë e ka proceduar me kohë dhe sipas ligjit si dhe sipas natyrës së kontestit dhe punës së gjykatës, ku dihet se në Departamentin e Përgjithshëm— Divizioni Civil gjyqtarët janë të ngarkuar me mbi 1.100 lëndë se cili dhe kanë një numër të madh të lëndëve të kthyer në rigjykim për të cilat kanë afat ligjor që duhet të caktohen. Sa i përket lëndës C.nr., ku avokati ka pasur pretendime se kjo lëndë është zhagitur me qëllim, kjo nuk qëndron pasi që si Gjyqtar i njëjti i ka kryer të gjitha veprimet procedurale në bazë të ligjit dhe parimit të çmuarjes së lirë të provave dhe ka përfunduar këtë lëndë me datë 19.04.2022 ku palët janë të udhëzuar për të drejtën e ankesës, gjë të cilën e kanë bërë me 25.07.2022. Sa i përket avokatit B.K., i njëjti me parashtrësën e datës 07.10.2021 ka hyrë edhe në çështje personale dhe e ka fyer gjyqtarin në fjalë "Ndoshta ky gjyqtar e ka edhe ndjenjën e inferioritetit sa i përket anës sime profesionale, pasi që dihet botërisht se i njëjti ka rënë disa herë nga provimi i jurisprudencës". Gjithashtu avokati B.K., edhe me parashtrësë të datës 09.09.2020 dhe me ankesën e datës 15.07.2022 e ka fyer gjykatën me deklaratën e tij, ku ka cekur se: " Vendimi i gjykatës është skandaloz, gjyqtari duhet të shkojë në trajnim të mësoj se cilat janë të drejtat absolute e cilat janë relative, një gabim të tillë nuk e bën edhe quni im tre (3) vjeçar e lërë më gjykata". Me këtë deklaratë Gjyqtari G.Sh., ka bashkangjitur edhe parashtrësat e avokatit drejtuar gjykatës me datë 07.06.2020, kundërpadi të datës 07.06.2020, ankesën e datës 07.10.202 dhe ankesën e datës 25.07.2022.

Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe kësaj Gjykate ka iniciuar hetimet për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shiqimin e ankesës së parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes, ka bërë shiqimin në shkresat e lëndës C.nr..... dhe pasi ka analizuar pretendimet ankimore, ka konstatuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Është vlerësim nga ana e kryetares së Gjykatës se në rastin konkret kemi të bëjmë me një lëndë C.nr..... në të cilën avokati B.K., përfaqëson palën paditëse dhe se ka parashtruar ankesë ndaj Gjyqtari G.Sh., në Këshill Gjyqësor, me datë 07.10.2021, ku U.D A.S.; me datë 04.11.2021 të njëjtën e ka refuzuar si të pabazuar. Ankesa e Cila është parashtruar tani me datë 18.07.2022 te Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren i ka ankesat e njëjta si në ankesën e lartcekur, andaj kryetarja konsideron se për këtë ankesë është vendosur një here dhe nuk mund të vendoset serish.

Sa i përket Kallëzimit Penal të parashtruar me datë 18.07.2022, gjykata nuk është kompetente që të vendosë dhe të veprojë sipas këtij kallëzimi dhe se kallëzimi penal duhet të drejtohet në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Gjithashtu në ankesë avokati B.K., ka cekur se ka pranuar aktgjykimin C.nr. ku gjyqtari në lidhje me provat e administruara në aktgjykim në mes tjerash ka cekur se: "provat nuk janë dorëzuar në kopje të vërtetuara apo në origjinal në mënyrë që gjykata të vlerësoj fuqinë provuese të tyre", duke pretenduar se gjyqtari G.Sh., ka bërë paraqitjen e fakteve të shtrembëruara në aktgjykim, ku ka theksuar se provat nuk janë dorëzuar në mënyrë origjinale për të cilat avokati propozon që t'i shqiptohet masa disiplinore.

Në lidhje me këtë Kryetarja gjykatës thekson se sa i përket provave të cilat janë administruar në lëndën kontestuese se a janë origjinale apo jo, nuk mund të deklarohet pasi që origjinaliteti i provave vërtetohet në një procedure të veçantë dhe me ekspertizë të veçantë.


Gjithashtu në lëndën C.nr. është vendosur me Aktgjykim ndaj të cilit është parashtruar ankesa sipas udhëzimit juridik dhe për të gjitha këto çështje kontestuese do të vendoset në Gjykatën e Apelit si shkallë e dytë. Procedura në shkallën e parë me aktgjykimin e nxjerre ka përfunduar dhe palët e kanë shfrytëzuar të drejtën ligjore në ankesë.

Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkretë nuk ka bazë për shkelje disiplinore në rastin konkret pasi që nuk ka prova, respektivisht nuk janë përmbushur dispozitat nga shkeljet disiplinore për gjyqtarë të paraparë nga neni 5 i Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe prokurorëve nr. 06/1--067.

Për arsytet që u cekura më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.8/22 me cit. 16.08.2022



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk e paraparë e drejta e ankesës.